

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **KOMUNA HANI I ELEZIT**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **659-25-9041-1-3-6**

Sa i përket tenderit për **Furnizim me material për mirembajtje dhe vegla pune**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj	Naim Axhami B.I.
NUI	810304220
Adresa	rr.Adem Jashari
Vendi	Hani i Elezit
Kodi postar	71510
Numri Telefonit	
Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj	Naim Axhami
Adresa elektronike	eltellahanielezit@gmail.com
Data e parashtrimit të ankesës	25.05.2026

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

Emri i avokatit
Adresa e plotë
Numri i Telefonit
Numri i faks-it
Adresa elektronike

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “ Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës” “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit”, apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:

Ankesa i përket grupeve:

Furnizim me material për mirembajtje dhe vegla pune

Furnizim me material për mirembajtje dhe vegla pune

659-25-9041-1-3-6

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po

Jo

Hapja është bërë përmes platformes së E-prokurimit

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po

Jo

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po

Jo

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontestit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se.

AK-Komuna Hani i Elezit nuk i ka shqyrtuar pretendimet ankimore sipas dispozitave ligjore andaj ka bërë shkeljen e nenit 108A të LPP-se. Prandaj mos shqyrtimi i pretendimeve ankimore rezulton se ZPP konkretisht AK-Komuna e Hanit të Elezit ka bërë shkelje ligjore, andaj keto rezultojnë që AK ka qenë subjektiv në kërkesën për rishqyrtim.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmblylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënie të Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 1 i LPP

Neni 6 i LPP

Neni 7 i LPP

Neni 10 i LPP

Neni 52.3 i LPP

Neni 56.3 i LPP

Neni 59 i LPP

Neni 30 i Rregullores se Prokurimit Publik

Neni 62 i LPP

Neni 108A i LPP

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë e rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Pretendimi ankimor nr.1

Permes platformes E-prokurimi jemi njoftuar se AK-Komuna Hani i Elezit me date 14.05.2026 se AK e ka anuluar ne teresi aktivitetin e prokurimit "Furnizim me material per mirembajtje dhe vegla pune", Numri i aktivitetit te prokurimit: 659-25-9041-1-3-6.

Arsyeja e anulimit te aktivitetit te prokurimit eshte se ofertat nuk kane validitet dhe ky arsyetim eshte jo ligjor dhe jo i qendrueshem sepse AK-Komuna Hani i Elezit, konkretisht Zyrtarja Pergjegjese e Prokurimit, detyrohet qe sipas Ligjit te ben vazhdimin e validitetit te ofertave, kete e percakton neni 30 i Rregullores se Prokurimit Publik.

Neni 30.4 e precizon ne menyre specifike se kur duhet AK te kerkon vazhdimin e validitetit te ofertave (citim):

Në situata të justifikueshme dhe/ose të veçanta kur vonesa të papritura shfaqen, duke nënkuptuar që procesi i vlerësimit nuk mund të finalizohet brenda afatit të periudhës së validitetit të tenderëve për arsye të detajeve komplekse teknike të sqaruara, Autoriteti Kontraktues do të kërkoj nga Operatorët Ekonomik të zgjasin validitetin e tenderëve të tyre. Autoriteti Kontraktues do të verifikojë që të gjithë tenderët pranojnë kërkesën për zgjatjen e validitetit të tenderit.

Neni 30.4 i Rregullores se Prokurimit Publik 002/2024 detyron AK qe ne raste komplekse AK duhet te kerkojne vazhdimin e validitetit te ofertave, kurse AK- Komuna Hani i Elezit, nuk e ka kerkuar fare vazhdimin e validitetit te ofertave qe e ka obligim ligjor te kerkoj validitetin e ofertave sipas dispozitave ligjore. Por ne heren e kaluar ne janar te vitit 2026 AK-ja, konkretisht nga ZPP-ja, na eshte kerkuar permes platformes se E-prokurimit vazhdimi i validitetit, per 60 dite, ku ne si OE ofertues e kemi dorezuar, dhe perseri Ak nuk e ka kryer vleresimin e ofertave ku e ka bere shkeljen e nenit 59 te LPP-se, sepse ka qene dasht qe vleresimi i ofertave te kryhet brenda 30 dite, andaj edhe pse ka pasur afat 60 dite perseri nuk eshte bere vleresimi i ofertave.

Por pas skadimit te afatit , nuk na eshte kerkuar fare te vazhdohet sipas nenit 30.4 te Rregullores se Prokurimit Publik 001/2022, andaj kjo shihet si tendencioze ndaj kompanise sone sepse shihet se qellimi i AK-se eshte tendencioze duke na eliminuar padrejtesisht dhe pa asnje baze ligjore.

Pretendimi ankimor nr.2

AK, konkretisht ZPP bashke me anetaret e komisionit ka bere shkeljen e nenit 7 te LPP-se duke na diskriminuar padrejtesisht sepse ne si OE jemi me dokumentacion te pergjegjshem dhe me cmim me te lire sipas kritereteve te DT-se dhe NJK-se, qe jemi i pergjegjshem sipas nenit 59.4 te LPP-se, por AK-se nuk i ka interesuar fare zbatimi i dispozitave ligjore ne procesin e vleresimit sipas kriterëve, por qellimi ka qene tendencioz, dhe kjo shihet haptazi se ne qenekemi si OE jo i deshiruar i Komunes se Hanit te Elezit, sepse kompanite e deshiruara AK-Komuna Hani i Elezit, ka menduar ti shperblej me kontrate pas rishpalljes, prandaj pasi qe keto padrejtesi po na behen ne kemi vendosur qe ti ndjekim deri ne fund te gjitha rruget ligjore te cilat do ta qesin drejtesine ne drite.

ZPP e Hanit te Elezit znj.Bekteshi dhe anetaret e komisionit te vleresimit kane bere shkeljen e nenit 59 te LPP-se, sepse nuk e kane kryer vleresimin e ofertave sipas dispozitave ligjore, konkretisht sipas kriterëve te kerkuara ne dosje, dhe vet ju si ZPP e keni obligim ligjor qe me kerkuar vazhdimin e afatit te validitetit te ofertave.

Prandaj, shihet se nuk ka qene qellimi i AK te zbatoj dispozitat ligjore, por AK as nuk e ka bere fare njoftimin per vazhdim te validitetit, dhe shihet se Zyrtarja Pergjegjese e Prokurimit ka ra nen ndikim te disa personave qe marrin vendime antiligjore dhe qe japin urdhera per anulim te procedurave (e dijme kete rast se kush ka dhene urdhera te tilla dhe kush e ka kercenu komisionin e vleresimit per anulim).

Personi qe ka dhene urdhera do te denoncohet para organeve per presion ndaj anetareve te komisionit.

Pretendimi ankimor nr.3

Poashtu ne si OE ofertues kemi kerkuar qasje ne dokumentacionet e tenderit sipas nenit 10 te LPP-se, qe te na jepet qasje apo te na dergohen dokumentet permes platformes, por ZPP i AK-Komuna Hani i Elezit, nuk na ka ofruar fare qasje as nuk na ka derguar dokumentet e kerkuara, duke bere shkeljen e nenit 10 te LPP-se.

Mos ofrimi i qasjes nga AK shihet si tendencioze per shkak se dyshojme se AK nuk ka kryer vleresimin e ofertave dhe per kete dyshojme se nuk keni as raport vleresimit, por AK ka bere nje anulim bllanko, sepse kjo eshte deshmuar me mos-dhënie e qasjes.

Kjo vie si rezultat se AK duke mos u bazuar ne kriteret e kerkuara te DT-se dhe NJK-se, konkretisht duke mos e zbatuar neni 52.3 i LPP-se dhe 56.3 i LPP-se, pasi qe nuk jane marr fare parasysh kriteret e kerkuara nga vet AK, por shihet se AK e ka bere vetem anulimin e aktivitetit.

Pretendimi ankimor nr.4

Pretendimi tjetër ankimor i joni eshte se ne vendimin e AK-se shkruan Komuna Ferizaj, kurse ne kemi konkuruar ne Komunen Hani i Elezit, kjo shihet se keni kryer vleresim dhe anulim bllanko te tenderit, duke e ngaterruar edhe autoritetin dhe duke mos i perfillur fare as dispozitat ligjore madje edhe duke e shenuar Komuna Ferizaj dhe keto veprime deshmojne se nuk kane pas interesim per vleresim te aktivitetit sipas kriterëve, por AK ka pas qellim vetem te anulimit te aktivitetit pa asnje baze ligjore dhe kjo shume lehte vertetohet sipas vendimit te AK-se.

Pretendimi ankimor nr.5

Shkelja tjetër e radhes eshte se AK nuk e ka bere anulimin bazuar ne dispozita ligjore dhe kjo e deshmon mos zbatimin e nenit 62 te LPP-se, sepse AK sipas nenit 62 te LPP-se duhet te kete kriteret per anulim te aktivitetit, sepse cmimi jone eshte me i lire.

Paragrafi 2 i nenit 62 te LPP-se e sqaron shume mire se ne cfare raste duhet te anulohet aktiviteti:

2. Autoritetet kontraktuese mund të përfundojnë atë aktivitet të prokurimit i cili nuk do të rezultojë në dhënie e kontratës vetëm për njërin nga arsyet:

2.1 të gjithë tenderët e përgjegjshëm përmbajnë çmime që e tejkalojnë buxhetin e autoritetit kontraktues për aktivitetin e prokurimit; apo

2.2. para hapjes së tenderëve, ndërprerja e aktivitetit të prokurimit është bërë e nevojshme për shkak të ngjarjeve objektive dhe që mund të demonstrohen dhe/ose arsyeve që janë jashtë kontrollit të autoritetit kontraktues dhe që nuk mund të parashikohen në kohën e inicimit të aktivitetit të prokurimit por kjo duhet të bëhet së paku tre (3) ditë para hapjes së tenderëve.

OE ofertues tjetër ka tejkaluar buxhetin e planifikuar per me shume se 3 fish apo ka konkuruar mbi 27,000 Euro.

Prandaj baza themelore e anulimit ka qene antiligjor per shkak se AK, konkretisht ZPP nuk ka kerkuar fare vazhdimin e validitetit te ofertave sipas nenit 30 te Rregullores se Prokurimit Publik 001/2022, edhe pse AK e ka obligim ligjor te ben vazhdimin sipas nenit 30.4 te Rregullores se Prokurimit Publik, andaj arsyetimi i AK-se per anulim te aktivitetit eshte tendencioz dhe jo i bazuar ne dispozita ligjore.

Poashtu ne si OE kemi pasur cmimin me te lire dhe jemi OE i pergjegjshem sipas kriterëve te kerkuara te Dosjes se tenderit dhe cdo devijim nga kriteret beni shkelje. Te gjitha shkeljet e bera dhe padrejtesite e bera do ti drejtohem edhe organeve te shtetit per mbrojtjet e te drejtave tona, sepse veprimet e tilla nuk jane ligjore dhe shihet direkt si tendencioze nga ju si ZPP dhe njesia kerkuese - drejtoria e administrates dhe te tjerat.

Pretendimi ankimor nr.6

AK nuk i ka shqyrtuar pretendimet ankimore sipas nenit 108A te LPP-se, sepse vet ZPP nuk ka dhene qasje sipas nenit 10 te LPP-se, duke na e mohuar qasjen ne dokumente te tenderit qe shihet se komuna ka qene tendencioz ndaj kompanise sone dhe qellimin e vetem e keni pas anulimin e aktivitetit.

Poashtu per shkeljet ligjore qe ka bere ZPP ne si OE do ti detyrohemi KRPP-se pasi qe ka bere shkeljen e nenit 25 te LPP-se, per revokim te licences dhe poashtu do te njoftohen Krimet Ekonomike dhe Prokuroria ne rast se nuk shqyrtohen pretendimet tona te kerkeses per rishqyrtim.

Bazuar ne pretendimet e paraqitura si me larte, kerkojme nga ana juaj si Organ Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) qete merrni:

V E N D I M

APROVOHET e bazuar kerkesa per rishqyrtim e OE. ELTELLA - Hani i Elezit, dhe te behet

ANULIMI i njoftimit per anulim te aktivitetit sipas vendimit te dates 14.05.2026

RIVLERESIM i aktivitetit pasi qe jemi ofertues pasi qe jemi OE i pergjegjshem sipas kriterëve te DT-se , poashtu gjate fazes se rivleresimit te

SHPERBLEHEMI me kontrate pasi qe i plotesojme te gjitha kriteret e kerkuara

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, në rast se përfshini pretendime për kompensim.

Deri tani kapin shumën 1500 euro

10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

- a) një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
- b) një kopje të publikimit për “Njoftimin e Dhënies së Kontratës” apo “Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimit për Anulim”.*
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,*
- e) bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontekstit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se,*
- f) Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe*
- g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.*

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*